



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2022:051894  
Datë: 07.11.2024  
Numri i dokumentit: 06420837

A.nr. 646/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Fllanza Hashani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit H.U.B nga fshati R, Komuna e Klinës, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve-Departamenti i Pensioneve, me bazë juridike, “anulim i aktvendimit”, pas shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur, me datën 01.11.2024, në prezencën paditësit e në mungesë të paditurës, merr këtë:

A K T G J Y K I M

**I. REFUZOHET** si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit, H.U.B nga fshati R, Komuna e Klinës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës nr.369577 dt.12.11.2021 dhe vendimi nr.03186 i dt.01.12.2021 dhe paditësit t’i njihet e drejta kontribut pagues të moshës dhe të obligohet e paditura ti kompensoj paditësit në mënyrë retroaktive diferencën në mes të pensionit bazë dhe atij kontribut pagues në Shumen mujore 214.00 Euro në muaj për kategorinë e tretë, më shkollim të lartë, dhe atë nga paraqitja e kërkesës më dt.05.11.2021 e deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi dhe për të ardhmen nga data e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit e deri nga data e ndërprerjes më dt.29.06.2021 e deri në ditën e marrjes së Aktgjykimit, si dhe për periudhën e ardhshme nga data e marrjes së Aktgjykimit shumën 214.00 Euro në muaj deri në ekzistimin e kushteve ligjore, ne afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

**II. Secila palë bart shpenzimet e veta procedurale**

## A r s y e t i m

Sipas padisë së paditëses, të parashtruar me dt.21.03.2022, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në këtë çështje juridike e cila është mbajtur, me dt.01.11.2024, në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në mungesë të palës së paditur.

Paditësi në padi, ka theksuar se me vendimin e të paditurës të dt.369577 e paditura kishte refuzuar ankesën e paditësit për njohjen e të drejtës në pensionin kontribut pagues të moshës. Më tej ka theksuar se vendimi i atakuar është në kundërshtim me gjendjen faktike, pasi paditësi kishte mbi 15 vite stazh kontributiv e që vërtetohet nga librezja e punës dhe letërkonfirmimi nr.7296/2015 i dt.03.03.2015 i lëshuar nga AKP, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë e tij si të bazuar.

Paditësi gjatë seancës gjyqësore ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, dhe ka theksuar se ka punuar në Fabrikën e Materialit Ndërtimor në Skenderaj nga dt.01.09.1983 e deri më 24.03.2005, ku kishte punuar si inxhinier i Makinerisë. Tutje ka theksuar se nuk është në njohuri nëse janë paguar kontributet nga Ndërmarrja ku kishte punuar ,por ka theksuar se në atë ndërmarrje kishte punuar deri në vitin 2005 kur ishte privatizuar, pre çka ishte njoftuar me vërtetin dhe ishte kompensuar pasi kishte paraqitur padi në Dhomën e posaçme të Gjykatës supreme dhe ishte vendosur me Aktgjykim. Njëherit ka precizuar kërkesëpadinë ashtu që ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës nr.369577 dt.12.11.2021 dhe vendimi nr.03186 i dt.01.12.2021 dhe paditësit t'i njihet e drejta kontribut pagues të moshës dhe të obligohet e paditura ti kompensoj paditësit në mënyrë retroaktive diferencën në mes të pensionit bazë dhe atij kontribut pagues në Shumen mujore 214.00 Euro në muaj për kategorinë e tretë, më shkollim të lartë, dhe atë nga paraqitja e kërkesës më dt.05.11.2021 e deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi dhe për të ardhmen nga data e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit e deri nga data e ndërprerjes më dt.29.06.2021 e deri në ditën e marrjes së Aktgjykimit, si dhe për periudhën e ardhshme nga data e marrjes së Aktgjykimit shumën 214.00 Euro në muaj deri në ekzistimin e kushteve ligjore, ne afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se bazuar në udhëzimin Administrativ 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues dhe Vendimit të Qeverisë nr.03/88 dt.20.05.2016, nuk ishin ofruar të dhëna për 15 vite stazh kontributiv, andaj ishte refuzuar kërkesa e paditësit, ndërsa paditësi i pakënaqur kishte ushtruar ankesë në Këshillin e Ankesave

pranë DAP të RK, dhe pas vlerësimit të ankesës e njëjta ishte refuzuar si e pabazuar me vendimin Nr.369577 dt.21.01.22 me arsyetimin se paditësi nuk kishte ofruar prova të mjaftueshme se përmbush kriteret për të qenë shfrytëzues i pensionit kontribut pagues, duke i propozuar gjykatës që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata në seancën e datës 02.07.2024 ka bërë administrimin e provave dhe atë: Vendimin e dt:21.01.2022, nga MFPT-PD, Vendimin e dt:12.11.2022, nga MFPT-PD, Librezën e punës dt:20.07.1978, Letër konfirmim nga AKP NR. 7296/2015, i dt:03.03.2025, Listën e pranimit të njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dy (2) fleta, Aktgjykimin e gjykatës Supreme SCEL-05006 i dt:06.06.2006, Shkresën nga AKP dt:24.03.2005, Vërtetimin e përvojës së punës M4 i dt:19.10.2021, Vërtetimin e përvojës së punës si dhe të ardhurat personale të realizuara M4 i dt:19.10.2021, Dosjen e kërkesës për pension themelorë i dt:08.11.2021, Vërtetimin (në gjuhën serbe) i dt. 17.11.2023, lidhur me përgatitjen shkollorë të Lartë të Makinerisë, Vërtetimin e përvojës së punës si dhe të ardhurat personale të realizuara M4 i dt:15.11.2021, Dy (faqe) fletëparaqitje për vitin 1989 dhe 1990, Listën pa emërtim me emra dhe shifra, Vërtetim e përvojës së punës si dhe të ardhurat personale të realizuara M4 i dt:07.10.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në shqyrtimin kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me vendimin e të paditurës, të dt.21.01.22 është refuzuar ankesa e paditësit, për shkak se nuk janë përmbushur kriteret për njohjen e pensionit kontribut pagues.

Paditësi i pakënaqur me këtë aktvendim, ka ushtruar padi, duke kundërshtuar të njëjtin si të kundërligjshëm.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e këtij vendimi, u bazua në Ligjin Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, që ka qenë në fuqi në kohën e vendimmarrjes përkatësisht nenit 8 të të njëjtit, ku përcaktohet se *“Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1.kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;1.2.duhet të ketë stazh pensional kontribut dhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës;01.01.1999;1.3.ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve*

*sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.*

Po ashtu gjykata iu referua edhe Udhëzimit Administrativ nr.09/2015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, që ka qenë në fuqi në kohën e vendimmarrjes, ku është përcaktuar se: *“Te gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontribut pagues, përkatësisht të siguarit me rastin e parashtrimin të kërkesës për pension kontribut pagues, bazuar në kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, duhet të sjellin dëshmitë relevante të përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, varësisht se për cilën kategori aplikojnë. 2.Përvec kushteve të përgjithshme të përcaktuara në dispozitat e Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, shfrytëzuesit aktual dhe ata që aplikojnë në të ardhmen, duhet të paraqesin dokumentet e nevojshme, si:2.1.Leternjoftimin e Republikës së Kosovës 2.2. Ekstraktin e Lindjes 2.3. të kenë stazh pensional kontributdhënës se paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 01.01.1999, sipas ligjit SPI-se Nr.26/83, i cili vërteton me ndonjë nga këto dokumente si: 2.3.1. vendimin se ka qenë shfrytëzues i pensionit kontributpagues sipas dispozitave të ligjit SPI-së Nr.26/83 para datës 01.01.1999; 2.3.2 çekun për pagesën e pensionit kontributiv sipas dispozitave nga Ligji i SPI-së të Kosovës; 2.3.3 librezën e punës me numrin amëz të të siguarit; 2.3.4 dëshmitë se i ka paguar kontributet vet ose punëdhënësi ku ka punuar; 2.3.5. ekstraktin nga M-4, nëse i posedojnë zyrrat pensionale, të cilat nxirren, verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës; 2.3.6. dëshmi se nuk është përfitues i pensionit nga ndonjë prej shteteve për të cilat Kosova nuk ka marrëveshje; 2.3.7 dëshmi për njohën e stazhit të punës për të pensionuarit e arsimit, të shëndetësisë dhe te tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës nga viti 1989-1999 e verifikuar nga Qeveria përkatësisht ministritë relative; 2.4 Të ofroj dëshmi se në Bazën e të Dhënave të ish Teknologjisë Informative, e ashtuquajtura Qendra Elektronike Llogaritare e ish BVI-SPI-së të Kosovës Regjionale, të cilat nxirren verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës në zyrrat pensionale përkatëse.*

*E po ashtu gjykata i'u referua edhe ligjit aktual, Ligjit Nr.08/L-248 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 04/L-131 Për Skemat Pensionale Të Financuara Nga Shteti, Respektivisht Nenit 8/A Pensioni Parcial Kontribut pagues i moshës, i cili ka përcaktuar 1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si*

*periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontribut pagues të moshës sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen. 2. Të drejtën në pension parcial kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim: 2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83, 2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989 si rezultat i masave të dhunshme; 2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh.*

Kështu në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë, përkatësisht me qëllim të konstatimit nëse ekzistojnë shkeljet e dispozitave në fjalë, nga ana e të paditurës, gjykata ka pasur parasysh provat e administruara në drejtim të përvojës së punës dhe atë, librezë e punës, letër konfirmimi i dt.03.03.201 nga të cilat vërtetohet se paditësi ka punuar në Ndërmarrjen Shoqërore Përparimi nga dt.01.09.1983 deri më 24.03.2005 por gjykata vlerësoi se në të njëjtat nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për të vërtetuar pagesën e kontributeve lidhur me këtë përvojë të punës, ndërsa nga librezë e punës rezulton se paditësi ka vetëm 1 ditë përvojë, andaj si të tilla nuk mund të merren për bazë për njohjen e stazhit të punës siç kërkohet me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ndërsa në bazë të vërtetimit për përvojën e punës dhe të ardhurat personale të realizuara M-4 i lëshuar nga Departamenti i Administratës pensionale të Kosovës, rezulton se paditësi gjithsejtë ka 8 vite e 4 muaj stazh, i cili i njihet si stazh kontributiv, që do të thotë se nuk janë ofruar dëshmi se paditësi ka 15 vite të stazhit kontributiv, siç përcaktohet me Ligj.

Prandaj nga të konstatuarat si më lartë, rezulton se paditura ka konstatuar drejte gjendjen faktike dhe ka aplikuar drejtë dispozitat materiale dhe procedurale. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se nuk është cenuar ligji në dëm të tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e përfaqësuesit të paditësit, se vendimi i të paditurës është në kundërshtim me gjendjen faktike, pasi paditësi kishte mbi 15 vite stazh kontributiv e që vërtetohet nga librezë e punës dhe letërkonfirmimi nr.7296/2015 i dt.03.03.2015 i lëshuar nga AKP, gjykata nuk i konsideroi me efekt për vendosje ndryshe në këtë konflikt administrativ.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi bazuar në nenin 64 të LPK-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6, 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.646/22 datë 01.11.2024

G j y q t a r j a  
Fllanza Hashani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.